



Res Publica &lt;qendra.respublica@gmail.com&gt;

## mbi kërkesën për informacion

**Amela Kora** <Amela.Kora@financa.gov.al>

Wed, Oct 20, 2021 at 8:18 AM

To: "qendra.respublica@gmail.com" <qendra.respublica@gmail.com>

Cc: Arlind Gjokuta <Arlind.Gjokuta@financa.gov.al>, Rudolf Papa <Rudolf.Papa@financa.gov.al>, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale <info@idp.al>

Përshëndetje,

Lidhur me kërkesën Tuaj për informacion, në zbatim të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", Ju bëjmë me dije në përgjigjen e kthyer prej nesh, nr. 15018, datë 30.08.2021 (bashkelidhur), jemi shprehur se rialokimi i fondeve të personelit nga ATSH, ministritë dhe institucionet publike, duhet të shoqërohen edhe me rialokim të fondeve operative. Nëse vlerësohet që këto fonde janë të pamjaftueshme, përdorimi i fondit rezervë duhet të bëhet me VKM të veçantë.

Në përfundim, bashkëlidhur praktika e projektvendimit "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Informim dhe Ceshtjet Publike".

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,



**AMELA KORA**

Drejtoria e Programimit, Standartazimit dhe Harmonizimit te Kuadrit Rregullator | Directorate of Programming, Standardization and Harmonization of the Regulatory Framework

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë | Ministry of Finance and Economy**

(A): Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri

(E): amela.kora@financa.gov.al | (W): www.financa.gov.al



1891

13213



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISÉ  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E ANALİZËS DHE PROGRAMIMIT BUHETOR

Nr. 15018  
Prot.

308  
Tiranë, më .../.../2021

Lënda: Mendim mbi një projektvendim.

KRYEMINISTRISË

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Në lidhje me projektvendimin "Për krijimin, organizimin dhe fuksionimin e agjencisë për informim dhe çështjet publike", ardhur nëpërmjet sistemit e-akte, parë në këndvështrimin buxhetor, shprehemi parimisht dakord me propozimin e përcjellë, por për miratimin e tij, vlerësojmë se:

1. Në ndarjen IV, në fund të pikës 3, duhet të shtohet fjalia: "...në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin buxhetor.".
2. Pikat 5 dhe 6, janë të panevojshme, pasi :
  - Lidhur me pikën 5, sqarojmë se përcaktimi i bërë në pikën 2, të ndarjes I, shpreh qartë që agjencia financohet nga buxheti i shtetit si njesi shpenzuese, dhe kjo nënkupton që agjencia ka fondet dhe personelin e saj të përcaktuar në vlera reale në aktet ligjore e nënligjorë të buxhetit të shtetit. Gjithashtu, duke qenë se në pikën1, të ndarjes IV, është përcaktuar koha e fillimit të funksionimit të Agjencisë, njëkohësisht përcaktohet edhe koha e fillimit të efekteve financiare. Për më tepër, që këto efekte do të shprehen dhe përcaktohen në kohën e miratimit të dy ose tre akteve të tjera nënligjore që lidhen me funksionimin e agjencisë, të cilat do të jene: VKM e përcaktimit të nivelit të pagave të Agjencicë (pra duhet të ndryshohet VKM 187/2017),VKM e transferimit/rialokimit të personelit dhe fondeve përkatëse të tyre nga institucionet dhe ministritë pranë agjencisë.
  - Lidhur me pikën 6, sqarojmë se rialokimi i fondeve të personelit duhet të shoqërohet edhe me rialokimin e fondeve operative për këtë personel. Pavarësisht nga ky rialokim, edhe nëse vlerësohet që fondet operative janë të pamjaftueshme, përdorimi i fondit rezervë bëhet me VKM të veçantë dhe përrnjedhojë, përcaktimi i pikës 6, nuk ka asnjë vlerë juridike dhe financiare, pasi një akt i Këshillit të Ministrave nuk detyron atë për hartimin e një akti tjetër të të njëjtit nivel.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**

(*Projekt*)  
**V E N D I M**

Nr. \_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PËR**

**KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUKSIONIMIN E AGJENCISË PËR  
INFORMIM DHE ÇËSHTJET PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe fuksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrat, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Informim dhe Çështjet Publike (më poshtë "Agjencia") e njojur për publikun edhe si "Agency for the Information and Public Affairs – AIPA", si person juridik publik, në varësi të Kryeministrat, me seli në Tiranë.
2. Agjencia financohet nga buxheti i shtetit, donacione dhe burime të tjera të ligjshme.
3. Agjencia ka si mision të sigurojë transparencën në lidhje me politikat, aktivitetet, projektet, eventet dhe aktet e Këshillit të Ministrave dhe të tjerave akte të ministrave dhe çdo institucioni të administratës shtetërore.

**II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AGJENCISË**

Agjencia ka këto përgjegjësi:

1. Organizon punën për të informuar dhe komunikuar me publikun dhe mediat.

- Organizon punën për të përgatitur qendrimet dhe sondazhet e qeverisë mbi çështjet me interes publik.

### **III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË**

- Agjencia e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.
- Agjencia drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili përgjigjet para Kryeministrit dhe përfaqëson agjencinë në marrëdhëniet me të tretët.
- Drejtori i Përgjithshëm i agjencisë emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra nga Kryeministri. Drejtori i Përgjithshëm duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
  - të jetë shtetas shqiptar;
  - të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
  - të ketë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional” të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë, në shkencat sociale dhe ose komunikim.;
  - të ketë përvojë pune, të paktën 7 vjet vjet në profesion apo në fusha të lidhura me informimin dhe komunikimin;
  - të shquhet për aftësi profesionale dhe figurë të pastër etiko-morale;
  - ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
  - të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
- Drejtori i Përgjithshëm lirohet ose shkarkohet nga detyra kur:
  - plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;
  - dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje;
  - deklarohet i paafitë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;
  - gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
  - jep dorëheqjen nga detyra;
  - kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës.

5. Drejtori i Përgjithshëm mbështetet në veprimtarinë e tij nga një zëvendësdrejtor i përgjithshëm i cili emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra nga Drejtori i Përgjithshëm.
  6. Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm, zëvendësdrejtorit të përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë të Agjencisë nregullohen në bazë të Kodit të Punës.
  7. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrat, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
  8. Zëdhënësi i Këshillit të Ministrave, statusi të cilil barazohet me atë të ministrit të shtetit, është Drejtori i Përgjithshëm dhe/ose zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i agjencisë apo çdo person tjetër i përcaktuar nga Kryeministri. Zëdhënësat e ministrave janë nëpunësit e agjencisë të përcaktuar nga Drejtori i Përgjithshëm te cilet punojne pranw institucioneve perkawse
  9. Në përbërje të Agjencisë, pranë secilës ministri dhe institucion qendror në varësi të Kryeministrat apo ministrave, krijohen struktura apo përcaktohen nëpunës përgjegjës për informimin dhe çështjet publike, të ngarkuar nga Agjencia me përfaqësimin e institucioneve respektive në komunikimet dhe raportet me publikun dhe mediat apo çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Drejtori i Përgjithshëm.
10. Agjencia, në funksion të realizimit të misionit të saj, kryen këto detyra:
- a) Drejton dhe koordinon punën e strukturave/nëpunësve përgjegjës për informimin dhe çështjet publike si dhe koordinon organizimin e aktivitetave informuese, konferencave për shtyp dhe çdo evenitë publik të këtyre institucioneve;
  - b) Në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në kabinetin e Kryeministrat, organizon konferencat për shtyp të Kryeministrat, si dhe e përfaqëson atë/qeverinë në këto konferenca, nëpërmjet zëdhënësit të Këshillit të Ministrave apo personit të caktuar nga Kryeministri me këtë detyrë;
  - c) Në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në ministrat, organizon konferencat për shtyp të ministrave, si dhe përfaqëson ata/qeverinë në këto konferenca, nëpërmjet zëdhënësve apo personit/personave të caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm me këtë detyrë;
  - ç) Në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, organizon aktivitete të tjera informuese për publikun dhe mediat mbi politikat, projektet, nismat, debatet mbi

- çështje publike, aktet e qeverisë apo të institucioneve të administratës shtetërore dhe sondazhe;
- d) Përdor të gjitha mjetet e komunikimit masiv/publik, digjital, ose jo, print ose online me qëllim realizimin e funksioneve të saj;
  - dh) Vëzhgon publikimet e mediave dhe mjetet e komunikimit masiv, për të evidentuar perceptimin dhe qëndrimin e publikut ndaj veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore. Për këtë qëllim, Agjencia mund të kryejë edhe sondazhe dhe hulumtime të tjera;
  - e) Siguron informimin e përditshëm të Kryeministratit mbi lajmet, debatet publike, çështjet me interes publik të paraqitura në median vendase dhe të huaj;
  - ë) Siguron informimin e përditshëm të ministrave dhe titularëve të institucioneve të administratës shtetërore mbi lajmet, debatet publike, çështjet me interes publik të paraqitura në median vendase dhe të huaj, si dhe në veçanti informacion mbi ngjarjet që lidhen me fushat e tyre të përgjegjësisë;
  - f) Mban kontaktet e nevojshme me strukturat homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe nënshkruan protokolle bashkëpunimi me ta;
  - g) Miraton specifikat në lidhje me blerjet e pajisjeve apo shërbimeve, në funksion të çështjeve të informimit, dhe marrëdhënieve me mediat/shtypin, çështjet publike që nevojiten të kryhen nga ana e ministrite dhe të gjitha institucioneve të administratës shtetërore, në përputhje me legjislacionin "për prokurimin publik";
  - gj) Raporton periodikisht te Kryeministri mbi veprimitarinë e saj, si dhe sa herë që kërkohet prej tij.
  - h) Informon institucionet e administratës shtetërore mbi lajmet, debatet publike, çështjet me interes publik të paraqitura në mediat vendase dhe të huaja që kanë të bëjnë me punen e qeverisë dhe/ose të institucioneve të administratës shtetërore apo çdo çështje tjeter;
  - i) Vlerëson, përmblehdh dhe përditëson informacionin që do të publikohet në lidhje me punët e qeverisë dhe çështjet me interes publik.
  - j) Organizon takimet periodike me mediat të zëdhënësit të Këshillit të Ministrave, zëdhënësve të ministrave sipas fushave të tyre, të personave përgjegjës në institucionet e tjera të administratës shtetërore, si dhe organizon dhe mban konferencat për shtyp gjatë të cilave u jepet perqigje pyetjeve të gazetarëve mbi zhvillimet e fundit politike. Pergjegjesi per shtypin ne zyren e zëdhënësit të Këshillit të Ministrave eshte pika e pare e komunikimit me gazetarët sipas parashikimeve të rregullores së Agjensisë.
  - k) Nxjerr njoftime për shtyp të lëshuara nga Kryeministri apo nga ministrat, drejtuesit e tjerë të institucioneve të administratës shtetërore.
  - l) Mban një faqe internet të dedikuar për profesionistët e medias, duke ofruar lajme, materiale shtesë dhe dokumente mbi politikat e qeverisë apo institucioneve

publike, si dhe oftron informacion aktual, informacione shpjeguese dhe dokumente origjinale mbi politikat e qeverisë për publikun gjerë.

- ll) Harton, boton dhe shpërndan broshura, manuale këshilluese/informuese, materiale audio/vizuale dhe çdo material tjetër të disponueshëm falas për publikun edhe në internet.
- m) Siguron edukimin qytetar me punën e qeverisë, si dhe organizon një program periodik të vizitave në godinat e institucioneve publike me intinerar dhe program të aksesuseshëm për qytetarët dhe në veçanti për fëmijët/të rinjtë/shkollat.
- n) Siguron përgjigje për shkresat dhe kërkesat për informacion në lidhje me çështjet e informimit dhe medias apo çështje të tjera në fushën e saj të përgjegjësisë.
- nj) Organizon, koordinon, drejton fushatat e informimit publik në lidhje me çështjet e fushës së përgjegjësisë të ministrive dhe institucioneve të tjera të administratës shtetërore;
- o) Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, Protokollin e Shtetit apo strukturat përgjegjëse organizon, koordinon, drejton eventet jubilare me rëndësi shtetërore;
- p) Siguron transmetimin e drejtpërdrejtë të aktiviteteve të Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit apo ministrave ose çdo aktivitet të përcaktuar nga drejtori i Përgjithshëm.
- q) Nënshkruan protokolle bashkëpunimi me Radiotelevizionin Shqiptar, Agjencinë Telegrafike Shqiptare apo çdo institucion tjetër publik apo privat në funksion të realizimit të misionit të saj.
- r) Kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga Kryeministri apo Këshilli i Ministrave.

11. Rregullorja që përfaqton metodat e brendshme të punës, përfshirë komunikimin me Kryeministrinë, ministritë dhe institucionet e tjera të administratës shtetërore, dhe sjelljen e personelit të agjencisë miratohet nga Kryeministri, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

12. Agjencia ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e Agjencisë përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet "Republika e Shqipërisë, Kryeministria, Agjencia për Informim dhe Çështjet Publike", në përpunhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

13. Vula e agjencisë ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përpunhje me legjislacionin në fuqi.

#### **IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

1. Agjencia fillon funksionimin e plotë të saj brenda datës 20 shtator 2021.
  2. Deri në plotësimin e strukturës së Agjencisë dhe caktimin e selisë së saj, Drejtori i Përgjithshëm do të mbështetet në detyrat e tij nga nëpunësit e Kryeministrisë.
  3. Funksionet, numri i punonjësve dhe fondet e dedikuara për informimin dhe monitorimin në Agjencinë Telegrafike Shqiptare, në ministritë apo institucionet publike kalojnë pranë Agjencisë.
  4. Nëpunësit aktualë të marrëdhënieve me mediat/zëdhënësit, pranë ministrive dhe institucioneve të administratës shtetërore që kalojnë tek Agjencia, trajtohen në bazë të përcaktimeve të legjisacionit në fuqi në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.
  5. Fondet buxhetore për aktivitetet që lidhen me fushën e përgjegjësisë dhe detyrat e agjencisë për institucionet e administratës shtetërore planifikohen në buxhetin vjetor të Agjencisë si dhe numri i personave. Efektet financiare të kësaj pike fillojnë më datë 20 shtator 2021.
  6. Kostot e shpenzimeve korente të Agjencisë për vitin 2021, mbulohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E M I N I S T R I**

**E D I R A M A**

RELACION  
PËR  
PROJEKT VENDIMIN  
“PËR  
KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUKSIONIMIN E AGJENCISË PËR  
INFORMIMIN DHE ÇËSHTJET PUBLIKE”

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË  
ARRIHEN**

Projektakti përbën një nismë për rikonceptimin dhe riorganizimin institucional të strukturave që ndjekin marrëdhëniet e Këshillit të Ministrave me mediat, informimin e publikut mbi veprimtarinë e qeverisë, si dhe që kujdesen për informimin e përditëshëm të Kryeministrit dhe ministrave mbi lajmet, aktualitetin dhe opinionin inmediatik e publik.

Në këtë kontekst, objektivi i projektaktit, përmes krijimit të këtij institucioni të ri të centralizuar, është realizimi i një komunikimi më efikas ndërmjet Këshillit të Ministrave nga njëra anë dhe medias e publikut nga ana tjetër. Kjo risi ka si qëllim fundor gjithashtu që komunikimi ndërmjet palëve të sipërpërmendura të jetë transparent dhe i plotë, duke mundësuar qoftë informimin tërësor të publikut mbi nismat e qeverisë, qoftë njohjen e kësaj të fundit me qëndrimin e publikut mbi nismat qeveritare.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN  
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN  
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi nuk është i parashikuar në programin analistik të projektaktieve dhe as në programin politik të Këshillit të Ministrave. Pavarësisht sa më sipër, ajo çka mund të thuhet është se ky projektvendim pasqyron vizionin e Këshillit të Ministrave për krijimin e një mekanizmi gjithëpërfshirës të komunikimit me publikun dhe median.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,  
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Në shtjellim të nevojës dhe përparësisë që ky projektakt përfaqëson, sqarojmë se aktualisht, në aparatin shtetëror në varësi të Këshillit të Ministrave, nuk ka një mekanizëm apo organ të posacëm, veprimtaria e të cilët të fokusohet tek marrëdhënia e qeverisë me mediat e publikun, si dhe që të sigurojë informimin e Kryeminisrit dhe të anëtarëve të Këshillit të Ministrave. Deri më tanë përgjegjësi të kësaj natyre janë ushtruar nga pjesë të stafeve ekzistuese të kabineteve, të cilët, në nivel të numrit të personelit në dispozicion, si dhe në nivel të kapaciteteve

inforastrukturore, nuk kanë patur burimet e mjaftueshme, për t'i evoluar këto funksione në spektrin që synohet të arrihet përmes kësaj nisme.

Konkrektisht, sikurse mund të kuptohet nga tërësia e kompetencave dhe detyrave të listuara në dispozitat e projektvendimit, të cilat propozohen t'i atribuohen Agjencisë së re, roli i zëdhënësit të qeverisë, nuk do të kufizohet më vetëm në një "ndërmjetës" të thjeshtë midis saj dhe medias e publikut dhe as vetëm në një "përçues" të imazhit apo mesazheve të qëverisë. Tanimë kjo strukturë e re do të marrë përsipër detyra që konsistonë në hulumtimin, sondimin dhe studimin e qëndrimit që publiku ka ndaj të gjitha nismave, projekteve dhe akteve të qeverisë, duke e çuar në një tjetër stadh marrëdhënien e kësaj të fundit me vetë publikun.

Ky element i veprimitarisë së Agjencisë, që lidhet me studimin e opinionit publik dhe që për herë të parë ngrihet në nivel institucional, nuk parashikohet vetëm përmotivë statistikore si qëllim në vetëvete, por do të shërbejë si një mjet përpërmirësimin e vetë politikave shtetërore të Këshillit të Ministrave. Nëpërmjet këtij elementi, Këshilli i Ministrave dhe i gjithë aparati shtetëror në varësi të tij, do të kenë mundësinë të evidentojnë në mënyrë më të shpejtë fushat në të cilat duhet ndërrhyrë qoftë përmes nismave ligjore ndryshuese, qoftë me projekte legjislative të reja, apo edhe në rastin më të thjeshtë: përmes veprimitarisë administrative/ekzekutive, kur kjo e fundit është e mjaftueshme përfundit me kënaqur pritshmëritë e publikut.

Një qasje e tillë për rolin e institucionit të ri do të mundësonë që komunikimi ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe publikut të mos mbetet në nivelin formal/sipërsaqësor, por të shndërrohet në një mekanizëm vetëpërmirësimi. Është pikërisht ky i fundit efekti kryesor i pritshëm i kësaj nisme.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Baza ligjore përfundimtare e vendimit të propozuar gjendet tek numri 6, pika 2, e ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe fuksionimin e administratës shtetërore", i cili përcakton se "*Përveçse kur parashikohen drejtpërdrejt nga ligji, institucionet e varësisë krijojnë dhe mbyllen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës apo përkatesisht Kryeministrit, dhe kanë personalitet juridik publik.*"

Nga përbajtja e tij, projektvendimi ka natyrë normative (akt-nënligjor me karakter normativ), sepse përmban rregulla të përgjithshme që lidhen me krijuimin, organizimin dhe detyrat e Agjencisë, që nuk shterojnë në zbatimin e tyre. Në këndvështrim të nenit 116 të Kushtetutës, i cili përcakton aktet normative me fuqi juridike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe hierarkinë e tyre, vendimi i propozuar është evidente se i përket kategorisë së "akteve normative të

Këshillit të Ministrave", të parashikuara në pikën 1 ç) të nenit. Në këtë kontekst, nga shqyrtimi i projektaktit rezulton se përmbytja e tij nuk tejkalon autorizimin që i është akorduar Këshillit të Ministrave nga dispozita e mësipërme ligjore. Duhet theksuar gjithashtu se projektvendimi respekton gjithashtu të gjitha kërkesat e listuara në paragrafin 3 të të njëjtin nen të ligjit nr. 90/2012, i cili shprehet si më poshtë:

*"Në vendimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e një institucioni të varësisë përcaktohen, të paktën:*

- a) emri dhe selia;*
- b) misioni;*
- c) funksionet administrative që i delegohen;*
- d) organizimi territorial, nëse është i zbatueshëm, si dhe detyrat administrative të degëve territoriale dhe kompetencat e tyre territoriale."*

Të gjithë elementët e mësipërën janë qartësishët të reflektuar në dispozitat e kërçeve I dhe II të projektvendimit dhe përrjedhojë përputhshmëria e tij me ligjin nr. 90/2012 është evidente. Më tej në nivelin kushtetues, nga pikëpamja lëndore kujtojmë se në bazë të nenit 95, paragrafi 2 i Kushtetutës "Këshilli i Ministrave ushtron çdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushtetëve të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore." Në këtë pikëpamje është e drejta e Këshillit të Ministrave që këtë veprimtari shtetërore, ta organizojë dhe strukturojë institucionalisht në mënyrën që ky organ vlerëson si më të volitshme, sikurse e shpjeguam edhe më sipër se është i autorizuar në mënyrë konkrete edhe nga ligji nr. 90/2012.

Për sa i përket çështjes së kushtetutshmërisë së projekt-vendimit, parë në këndvështrim të nenit 118 të Kushtetutës, ai përbën një akt nënligjor të nxjerrë në respektim të të tre kriterieve të parashikuara nga kjo dispozitë kushtetuese:

*1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë.*

Përveç çështjes së bazueshmërisë ligjore, të shtjelluar më sipër, vendimi i propozuar do të nxjarrë nga Këshilli i Ministrave - organ kushtetues.

*2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.*

Miratimi i këtij projektakti është qartësishët në respektim edhe të këtyre kritereve, pasi të gjitha përcaktimet e dispozitës kushtetuese të mësipërme, lidhur me autorizimin për nxjerrjen e aktit, organin kompetent dhe përbajtjen, gjunjë pasqyrim në ligj.

*3. Organ i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t'ia delegojë kompetencën e tij një organi tjeter.*

Argumentimin e pajtueshmërisë me këtë parashikim e gjykojmë të panevojshëm, duke qenë se vetë nisma për propozimin e aktit ndaj Këshillit të Ministrave, është në vete tregues i saj (pajtueshmërisë).

Si i tillë, bazuar në argumentimin e parashtruar më sipër, vlerësojmë se projektvendimi i përbahet kufijve të përgjithshëm të vendosur nga normat/aktet më të larta, si dhe rcspekon përbajtjen e tyre.

Për sa i përket çështjes së pozicionimit në raport me normat juridike në fuqi (të legjislacionit të brendshëm të fushave të tjera të ngashme/të lidhura me legalizimin), gjykojmë se projektakti është në harmoni me dispozitat e legjislacionit që tregullojnë veprimtarinë administrative të institucioneve shtetërore.

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRJIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me *Acquis Communautaire*.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi i paraqitur për shqyrtim përmban 23 dispozita të strukturuara në katër kriterë.

Kreu i parë i projektvendimit përmban tre dispozita të përgjithshme që përcaktojnë qëllimin e projektvendimit, statusin dhe misionin e Agjencisë si person juridik publik në varësi të Kryeministratit si "të sigurojë transparencën në lidhje me politikat, aktivitetet, projektet, eventet dhe aktet e Këshillit të Ministrave dhe të tjera akte të ministrave dhe çdo institucioni të administratës shtetërore."

Kreu i dytë parashikon përgjegjësitë funksionale të Agjencisë, që konsistojnë në: "Organizimin e punës për të informuar dhe komunikuar me publikun dhe mediat,

*Organizimin e punës për të përgatitur qendrimet dhe sondazhet e qeverisë mbi çështjet me interes publik.”*

Kreu i tretë përmban rregullat për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë, duke detaujar në mënyrë të vecantë tërësinë e detyrave dhe funksioneve të saj, sic janë të listuara në pikën 10 të këtij kreu. Në këtë kre përcaktohen gjithashtu rregullat që kanë të bëjnë me strukturën e përgjithshme institucionale të Agjencisë, e cila do të përfshije edhe njësitë e informimit pranë ministritive dhe institacioneve qendrore, me kriteret që duhet të plotësojë personi që emërohet Drejtor i Përgjithshëm dhe rregullat për emrin dhe lirimin e tij nga detyra. Përpos samë sipër, gjenden të parashikuara në këtë kre edhe dispozitat pëmiratimin e rregullores së brendshme, për vulën, stemën dhe logon e Agjencisë, si dhe dispozita që përcakton se marrëdhëniet e punës së punonjësve të Agjencisë.

Së fundmi, kreu i katërt përmban dispozitat kalimtare dhe të fundit të cilat normojnë periudhën e ngritjes së Agjencisë së re, sipas afateve dhe procedurave përkatëse. Në këtë kre irregullohet mënyra e funksionimit të Agjencisë deri në përfundimin e procesit të konstituimit të saj.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucioni i ngarkuar për zbatimin e këtij projektakti është vetë Agjencia që krijohet rishtaz përmes tij, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë që përcaktohen në dispozitat e vecanta të projektaktit.

## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Hartimi i Projekt-aktit të paraqitur për shqyrtim është realizuar nga strukturat pranë Kryeministrisë.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Sikurse është përcaktuar në pikën 3 të kreut IV të projektvendimit, Agjencisë do t'i rialokohen fondet e dedikuara për informim dhe monitorim, që deri para hyrjes në fuqi të këtij vendimi kanë qenë të caktuara për ATSH, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore. Në këtë kuptim, realizimi nga pikëpamja financiare i veprintarisë së Agjencisë, mundësohet nga transferimi (rialokimi) i këtyre fondeve. Gjithashtu, për sa u përket shpenzimeve korente për vitin 2021, pika 6 e të njëjtit kre parashikon se kostot e tyre do të përballohen nga Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

